

## Mbyllet dita e trete e pergatitjeve ne France

nga Administrator

E mërkurë, 08 Qershor 2016 19:25

---



Sot mbasdite eshte mbyllur edhe dita e trete e pergatitjeve qe ekipi yne kombetar po ben ne France. Ne stervitjen e paradites, kontigjenti i lojtareve te Shqiperise ka qene i plote. Me ekipin jane bashkuar edhe Mavraj, Abrashi dhe portieri Berisha te cilet kishin probleme fizike. Ne stervitjen e paradites lojtaret kane qene te perqendruar ne pjesen taktike dhe ne ushtrimet me top. Ndersa stervitja e pasdites eshte bere me dyer te mbylluara per mediat.